



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/133
Datë: 07.07.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 korrik 2010, mori

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe Plotësohet Strategjia Legjislative për vitin 2010.
2. Në Strategjinë Legjislative për vitin 2010 shtohet Projektligji për Prokurim Publik në Kosovë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Zyra për Shërbimet të Ndihmës Juridike në Zyrën e Kryeministrit.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/133

Datë: 07.07.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 korrik 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet me vërejtje Projektligji për Prokurim Publik në Kosovë.
2. Obligohet Zyra për Shërbimet e Ndihmës Juridike në Zyrën e Kryeministrit për përfshirjen e vërejtjeve në tekstin e projektligjit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/133

Datë: 07.07.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 korrik 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet Platforma Vjetore e Politikës së Inteligjencës dhe Sigurisë.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që Platformën nga pika 1. e këtij vendimi t'ia dërgoj për informim Komisionit për Agjencinë Kosovare të Inteligjencës në Kuvendin e Kosovës, dhe Drejtorit të Agjencisë Kosovare për Inteligjencë për veprim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë